



ARTIVIZMI

MANUALI



MASTERPEACE
Creating peace.
Together.





Funded by the European Union

Financuar nga Bashkimi European. Qëndrimet dhe mendimet e paraqitura janë të autorit(ëve) dhe nuk paraqesin domosdo qëndrimet e Bashkimit European apo të Agjencisë Ekzekutive Europiane për Edukim dhe Kulturë. As Bashkimi European, as autoriteti që ka dhuruar grantin nuk mund të mbahen përgjegjëse për to.

TITULLI:

Manuali “ARTIVIZËM”

PROJEKTI:

“DO U ACTism”, i financuar nga Bashkimi Europian.

Partnerët e projektit janë:

STITCHING MASTERPEACE, Holandë

Ludbreška Udruga Mladih Entuzijasta (LUMEN), Kroaci

Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime (SIT), Kosovë

MasterPeace Morocco (MPM), Marok

Lebanese Development Network (LDN), Liban

PUBLIKUES:

STITCHING MASTERPEACE, Holandë

REDAKTORE:

Natalia van der Wee

AUTORË/E:

Aart Bos

Igor Dobec

Karin Rozema

Marko Markac

Natalia van der Wee

DIZAJNI GRAFIK:

LDN

2023

Projekti DOU**ACT**ISM

DO U ACTism është projekt i financuar nga Bashkimi European. Projekti është bashkë-krijim i pesë organizatave të pavarura jo-qeveritare (OJQ) nga pesë shtete: STITCHING MASTERPEACE (Holandë), MasterPeace Morocco (Marok), LUMEN (Kroaci), SIT (Kosovë), dhe LDN (Liban). Misioni ynë i përbashkët është t'i mobilizojmë talentet për një të ardhme të qëndrueshme dhe të kontribuojmë në Obejktivën e Zhvillimit të Qëndrueshëm 4 (SDG 4) – Arsim cilësor – dhe Obejktivën e Zhvillimit të Qëndrueshëm 16 – Paqe dhe Drejtësi. Organizatat ofrojnë eksertizë në edukimin joformal dhe punën rinore, duke përfshirë punën me minoritete dhe rininë e paprivilegjuar. Partnerët kanë përvojë në ndërtim të paqes, fuqizim të rinisë, dhe punë online.

Ne besojmë në ndërtimin e një shoqërie kohezive që është diverse dhe gjithëpërfshirëse, dhe përbëhet nga qytetarë/e aktive/e që janë të angazhuar në jetën shoqërore, ekonomike, kulturore, dhe politike.

Metodologjia jonë e teorisë së ndryshimit e udhëheq qasjen tonë, në përputhje me strategjinë e BE-së për rini, për t'i përfshirë, lidhur, dhe fuqizuar grupet tona të synuara:

- Përfshij: mobilizo, frymëzo, dhe lidh talentet e reja lokale përmes fuqisë transformuese të muzikës, artit, dhe lojës.
- Lidh: organizo dialogje dhe bashkoi të gjithë vendimmarrësit lokal, duke forcuar bashkëpunimin dhe bashkëveprimin.
- Fuqizo: krijo perspektiva përmes trajnimeve për lidërsip, programeve për ngritje të kapaciteteve, dhe krijimit të ndërmarrjeve shoqërore, duke u mundësuar të rinjve/rejave të bëhen ndryshues/e aktivë/e.

Projektet tona të kaluara dhe analizat e nevojave kanë dëshmuar një hendek të madh të besimit mes segmenteve të ndryshme të shoqërisë, sidomos mes “të pasurve dhe të varfërve”, autoriteteve dhe shoqërisë civile. Shumë të rinj/reja ndihen të marginalizuar/a dhe besojnë se zërat e tyre nuk janë të rëndësishëm. Ne synojmë t'i përfshijmë ata/o që janë të lënë/a pas, veçanërisht vajzat e reja në zonat rurale, sidomos në shtetet si Maroku, Kosova, dhe Libani.

Duke prezantuar konceptin e “DO U”, me origjinë nga libri “Ekonomia Donat” nga Kate Raworth, ne theksojmë rëndësinë e kohezionit social brenda kufijve planetarë. Partneri ynë DEAL (Doughnut Economics Action Lab), ofron ekspertizë të paçmueshme në këtë fushë.

“ACT-ism” përfaqëson pjesën tonë të projekteve të orientuar në veprime, duke theksuar uregjencën për ta adresuar kohezionin social dhe sfidat ambientale. Ai poashtu i referohet konceptit “Artistët krijojnë së bashku”, duke i dhënë rëndësi përdorimit të kreativitetit, artit, dhe kulturës për t’i përfshirë dhe lidhur ndividët. ACT simbolizon përgjegjësinë tonë kolektive si arkitektë të së ardhmes sonë.

Rreth këtij manuali

Ky manual është zhvilluar si një resurs inovativ për trajnerët dhe punëtorët/et rinorë/et, për t'i përfshirë, lidhur, dhe fuqizuar të rinjtë që të përdorin forma të ndryshme të artit si mjet për ndryshim shoqëror.

Analiza e nevojave tregon se të gjithë partnerët dhe bashkëpunëtorët tonë kanë nevojë për materiale për edukimin joformal (MEJF) për t'i ngritur kapacitetet dhe aftësinë e tyre për t'u përfshirë dhe lidhur me të rinjtë. Ikja e forcës punëtore dhe shkëputja mendore e të rinjve është sfidë e madhe. Mungesa e perspektivës është e lidhur ngushtë me perspektivat e punës. Ne synojmë të ofrojmë materiale inovative dhe të gatshme për përdorim për ta rritur ndikimin tonë si shtytës drejt transformimit dhe, më e rëndësishmja, t'i përkrahim dhe inkurajojmë të rinjtë/rejat që ta marrin në duar të ardhmen e tyre.

Nevoja për të vepruar dhe mungesa e ekspertizës dhe metodologjive të qasshme teorike dhe praktike, si dhe mjeteve inovative për të punuar në sfida shumë-dimensionale në shoqëri është e madhe. Epoka digjitale kërkon transformim në të gjitha nivelet. Punëtorët/et rinorë/e deklarojnë nevojë për përkrahje në organizimin e formateve të përziera të mësimit digjital në nivelin teorik-didaktik, si dhe në nivelin praktik. Manuali mund të përdoret si burim inovativ i informacionit për të drejtuar një program të tillë të edukimit joformal me objective specifike adresimin e gjithëpërfshirjes shoqërore dhe sfidave ambientale përmes formave të ndryshme të shprehjes artistike.

Programi i edukimit joformal është dizajnuar që të jetë një qasje e mësimi të kombinuar. Përvoja e shkëlqyer e mësimi të kombinuar ngrihet mbi themelet e mësimi ekspert me prani fizike. Ky ndërveprim mund të ndodhë në çfarëdo formati: offline, në klasë, dhe në mënyrë virtuale, përmes mjeteve online. Ky mund të ndodhë në formate të ndryshme: edukimi formal, edukimi joformal, apo përmes mësimi joformal. Risia e kësaj qasjeje qëndron në një kombinim jo vetëm të edukimit online me atë tradicional, por në dizajnimin e përvojave të reja dhe krijimin e një lënde që i kombinon teknikat më të mira të të gjitha llojeve të mësimi.

Qasja jonë e mësimit të kombinuar në këtë program të edukimit jorformal i identifikon 3 lloje të të mësuarit:

- 1) I udhëhequr nga mësime dhënësi/ja – ndërveprim me një mësime dhënësi/e. Punëtori/ja rinor/e/trajneri/ja. Punëtori/ja/trajneri/ja/mësime dhënësi/ja nuk është vetëm burim i frymëzimit por burim frymëzimi, mentor/e, një dorë ndihmëse;
- 2) Punë grupore – ndërveprim me bashkëmoshatarët/et. Aftësia për të punuar në grup dhe për të arritur rezultate (qasje bazuar në projekte);
- 3) Mësim i vetes – të rinjtë marrin vetë përgjegjësinë dhe pronësinë e asaj që mësojnë. Aftësia për të punuar individualisht, për t'u koncentruar në target, dhe për të arritur rezultate personale.

Lënda e trajnimit është e bazuar në principet dhe metodat e arsimit jorformal. Ajo përbëhet nga metoda interaktive për t'iu përputhur nevojave të pjesëmarrësve/eve duke përfshirë: inpute teorike, aktivitete individuale dhe grupore, sfida grupore, prezantime, lojë me role, raste për studim, diskutime dhe metoda të tjera. Manuali dhe të gjitha materialet shtesë janë krijuar në gjuhën angleze por do të përkthehen në gjuhët kombëtare të partnerëve lokal: Shqip, Arabisht, Serbo-kroatisht, dhe Holandisht – për shumëfishim më të lehtë. Videot nga YouTube që janë si prezantime mund të përdoren me titra në gjuhën lokale ose mund të zëvendësohen me video të ngjashme me temën e njëjtë në gjuhët lokale.

Audienca e targetuar e këtij manuali janë punëtorët/et rinorë/e, trajnerët/et apo udhëheqësit/et e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) she përfituesit përfundimtarë të mësimit – të rinjtë e moshës mbi 16 vjeç.

Hyrje

Arti për një kohë të gjatë ka shërbyer sin jë mjet i fuqishëm për shprehjen e emocioneve, sfidimin e normave shoqërore, dhe transformimit frymëzues. Ky program inovativ për EJK mbi artvizimin u ofron të rinjve një perspektivë të freskët për përdorimin e veglave të shumta artistike për transformim shoqëror dhe ambiental. Programi mësimor i fton pjesëmarrësit/et që t'i eksplorojnë aftësitë dhe talentet e tyre, dhe të mësojnë si t'a kontribuojnë dhuratën e tyre të veçantë në shoqëri. Programi eksploron fuqinë transformuese të artit dhe rolin e tij në formësimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të barabartë. Përmes aktiviteteve përfshirëse dhe diskutimeve frymëzuese, përmes zbulimit të ndërthurjes së artit dhe ndryshimit shoqëror, të rinjtë e ri-imagjinojnë botën tone dhe punojnë për një të ardhme më të ndritur.

Sesioni 1: ARTIVIZMI – Frymëzimi.

Në këtë session, pjesëmarrësit/et do ta eksplorojnë ndikimin e thellë të artit si katalizator për ndryshim social. Artistët/et kanë një aftësi të veçantë ta reflektojnë botën rreth tyre përmes punëve kreative të tyre. Përmes portretizimit të realiteteve të çështjeve shoqërore, politike, dhe mjedisore, arti vepron si një pasqyrë që i detyron individët të përballen me të vërteta jo të kënaqshme. Ai e ngrit vetëdijen dhe i fton shikuesit/et që ta vënë në pikëpyetje status quo-në, duke i sfiduar besimet e rrënjësura dhe duke frymëzuar mendimin kritik.

Në këtë funksion reflektues veprat artistike mund të shihen si shprehje artistike e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) dhe sfidave ambientale me të cilat përballet shoqëria jonë. Në këtë session, pjesëmarrësit/et do të njoftohen me SDG-të dhe do të ftohen t'i sfidojnë kufizimet aktuale duke e parashikuar një të ardhme alternative, që lulëzon për komunitetin e tyre apo qytetin ku jetojnë.

Sesioni 2: Talentet.

Ne besojmë se bota nuk i ka 7 miliardë probleme, por 7 miliardë talente. Ne besojmë se të gjithë njerëzit kanë dhe mund t'i përdorin talentet e tyre. Nga kreativiteti artistik tek aftësitë për të zgjidhur probleme, nga lidhësi tek empatia e thellë, ekziston një varg i gjerë i talenteve që gjenden brenda secilit/ës prej nesh. Secili individ posedon një talent të veçantë dhe të qenësishëm që pret të zbulohet dhe të rritet. Të rinjtë

janë të cenueshëm sidomos për shkak se vuajnë nga gjykimi ndaj vetvetes dhe i vënë në dyshim vlerat e tyre personale. Në këtë session mësimor, pjesëmarrësit/et do ta zbulojnë një sërë talentesh që dallojnë shumë nga personi në person. Këto talente mund të zbulohen, të lulëzojnë dhe të bëjnë një ndikim pozitiv në botë. Përqaftimi i nocionit se të gjithë kanë një talent promovon gjithëpërfshirjen dhe feston shumëllojshmërinë e pikave të forta dhe aftësive që i bëjnë komunitetet tona të lulëzojnë.

Sesioni 3: ARTIVIZMI – Ideimi.

Nga arti pamor deri te muzika, teatri te vallëzimi, artistët përgjatë historisë kanë shfrytëzuar shprehjet e tyre kreative për të hedhur dritë mbi padrejtësitë, për t'a nxitur dialogun, dhe për t'i mobilizuar komunitetet. Nga këngët e fuqishme protestuese te arti rrugor me ndikim, artistët/et kanë përdorur platformat e tyre për t'i sfiduar sistemet shtypëse dhe për të avokuar për drejtësi. Shprehjet artistike ofrojnë rrugë për mospajtim, duke thyer barrierat gjuhësore dhe kulturore. Në këtë session, pjesëmarrësit/et eksplorojnë se si arti e frymëzon imagjinatën, kreativitetin, dhe inovacionin. Ata/o mësojnë më detajisht për format e ndryshme të artit dhe zgjedhin cila metodë artistike do të shërbente më së miri për ta adresuar një problem specifik shoqëror apo ambiental për të cilin shqetësohen.

Ky program i edukimit joformal synon të eksplorojë artin si katalizator për ndryshim shoqëror. Nëpërmjet sesioneve interaktive dhe ushtrimeve kreative, pjesëmarrësit gërmojnë në fuqinë transformuese të artit, nga roli i tij si pasqyrë e shoqërisë deri te aftësia e tij për të nxitur ndjeshmërinë, për të frymëzuar aktivizmin dhe për të parashikuar të ardhmen alternative. Ata/o zbulojnë potencialin e artit si një mjet për të krijuar një botë më të drejtë dhe më të barabartë.

Fuqia e ndryshimit qëndron brenda komuniteteve dhe veprimit kolektiv. Si rezultat i këtij programi EJM, pjesëmarrësit/et do të fitojnë njohuri të vlefshme për potencialin për transformimin e sistemeve ekologjike dhe sociale në komunitetin e tyre duke përdorur fuqinë e butë të artit. Të pajisur me njohuritë e talenteve të tyre, frymëzimin dhe një kuptim të thellë të lidhjeve midis shprehjeve artistike dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), pjesëmarrësit do të jenë të pajisur mirë për t'u bërë një katalizator për ndryshim.

Programi i Edukimit Jo-Formal (NFE).

Ky program përbëhet nga dizajne të detajuara të sesioneve të bazuara në parimet e të mësuarit të përzier. Materialet përfshijnë shtojca me udhëzime shtesë për trajnerët/et dhe fletëpalosje për pjesëmarrësit/et. Të gjitha sesionet ofrojnë vegëza me prezantime të gatshme për përdorim (Canva) për të mbështetur nevojën e burimeve dixhitale vizuale dhe multimediale.

Në të njëjtën kohë, programi lë shumë liri për të bërë ndryshime dhe rregullime për të përmbushur nevojat specifike të trajnerëve/eve, pjesëmarrësve/eve dhe mund të përshtatet për përdorim në shumë formate.

Përshkrimi dhe qëllimet mësimore

Sesioni: Frymëzimi

Studentët/et njoftohen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG-të) dhe si këto synime globale lidhen me sfidat lokale. Bazuar në këtë, ata/o krijojnë një vizion për një botë më të qëndrueshme (“qytet i lulëzuar”) dhe mësojnë se si të shprehin në mënyrë krijuese ëndrrën e tyre, duke përdorur Artin për Ndryshimin Social.

Synimet e mësimit

- Njohuria: E kuptoni se çfarë janë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.
- Njohuria: E dini se në cilat vlera dhe SDG të Bashkimit European bazoheni.
- Kuptimi: mund t’i emërtoni sifdat më urgjente globale.
- Aftësia: I ndërlidhni sfidat në kontekstin tuaj lokal me çështjet globale dhe vlerat e BE.
- Aftësia: ju shprehni në mënyrë kreative mendimin/ëndrrën tuaj për një botë më të qëndrueshme dhe më të drejtë shoqërore. Dhe shpjegoni se si dëshironi të kontribuoni.
- Qëndrimi: jeni kritik dhe i hapur për të eksploruar opsionet. Ju i lidhni gjetjet tuaja me vlerat tuaja thelbësore.

Sesioni: Talentet

Ky është sesioni i programit të arsimit joformal në kuadër të projektit DO U ACTism. Në këtë sesion diskutojmë temën “talentet”. Pjesëmarrësit/et zbulojnë talentet e tyre dhe të tjerëve.

Qëllimet mësimore

- Njohuri: ju e dini se çfarë kategorie talentesh ekzistojnë bazuar në teorinë e inteligjencës së shumëfishtë.
- Kuptimi: ju e kuptoni se çdo person ka talentin e vet unik.
- Aftësia: ju tregoni se cilat janë talentet tuaja.
- Qëndrimi: jeni të sigurt dhe të motivuar për të punuar në zhvillimin e talentit tuaj.

Sesioni: Ideimi

Pjesëmarrësit/et njihen me forma të shumta të arteve që mund të përdoren për të adresuar problemet sociale dhe mjedisore. Ata mësojnë të zgjedhin forma të artit që të dyja: edhe pasqyrojnë më së miri interesat dhe pozicionin e tyre personal, edhe përputhen me agjendën. Pjesëmarrësit/et do të performojnë dhe praktikojnë gjenerimin e ideve për veprimet e komunitetit.

Qëllimet mësimore

- Njohuri: ju i njihni pjesët e ndryshme të procesit të ideimit.
- Kuptimi: ju e kuptoni se si ndani dhe përbashkoni idetë.
- Aftësia: ju jeni në gjendje të përdorni procesin e ideimit, së bashku me ekipin tuaj, për të formuluar idenë tuaj për ndryshim pozitiv.

Mjetet

- Arti për Ndryshim Social
- Kuizi i SDG - art Kahoot
- Krijimi i tabelës së disponimit
- Ekspozita online
- Kuiz i talenteve
- Re fjalësh
- Punëtori e formave të artit
- Retë stuhi mendimesh

Struktura¹

Part	Topic	Set-up
1.	Inspiration	
1.1.	An introduction into SDG's	Offline, in-class, teacher-led
1.2.	Making moodboard	Online, self-study, homework assignment
1.3.	Online exposition	Online, in-class, group-work
2.	Talents	
3	Ideation	
3.1.	Workshop: Forms of expression	Offline, in-class, teacher-led
3.2.	Finding your form	Offline, in-class, teacher-led

¹ All activities of the set-up can be replaced by online/offline versions based on specific situations at school or other external reasons.

Dizajni i Detajuar i Sesionit

Sesioni 1. ART për Ndryshim Social: Frymëzim

Materialet:

- [Prezantimi 1](#)
- [Manuali i trajnerëve](#)
- [Fletore e punës për pjesëmarrësit/et](#)

1.1: Një hyrje në SDG

Time	Instructions	Materials
5 min	<p>Prezantoni "Arti për Ndryshim Social"</p> <p>Interesi - Tërhiq vëmendjen e nxënësve përmes lojës së fjalëve: Art + Aktivizëm = Artivizëm. Jepni një shpjegim të shkurtër mbi këtë koncept dhe një shembull (foto e çantave të shpinës së UNICEF-it).</p> <p>Nevoja - Arti është një mënyrë e fuqishme për të bërë një ndryshim në një botë që përballlet me shumë sfida.</p> <p>Koha - Trego afatin kohor të sesioneve.</p> <p>Reagimi - Pjesëmarrja aktive në të gjitha fazat e procesit artistik.</p> <p>Objektivi - Trego objektivat</p>	Prezantimi 1
10 mins	<p>Nevoja për ndryshim</p> <p>Këtu do të eksplorojmë sfidat e botës dhe do të njihemi me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.</p> <p>Shikoni videon rreth Qëllimeve Globale dhe diskutoni::</p> <ul style="list-style-type: none">• Çfarë duhet ndryshuar në botë? (mbledhni mendime, inkurajoni studentët)• Pse është i nevojshëm ky ndryshim? (Shkruani arsyet në një kolonë të veçantë - ky është baza e motivimit)• Me cilat vlera të BE-së lidhet kjo?	Prezantimi 1 Video rreth qëllimeve globale

	<p>Nëse nuk përmenden këto më poshtë, sigurohuni që të shtoni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ka 17 objektiva të zhvillimit të qëndrueshëm • “Agjenda 2030” është afati kohor që kemi vendosur për arritjen e këtyre objektivave. • Çdo objektivë matet me një numër objektivash (169 në total) • Për çdo objektivë ka ngjarje, publikime dhe veprime që mund t'i gjeni në faqen e internetit të SDG-ve. 	
5 min	<p>Ushtrimi i galerisë SDG</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Eksplorimi i pjesëve ekzistuese të artit në lidhje me SDG-të dhe zgjedhja e një (ose të disa/në grupe nëse është e nevojshme) 2. Hulumtoni individualisht pjesët tuaja. 3. Në grupe: Ndani atë që keni gjetur dhe përgjigjuni pyetjes udhëzuese. 4. Të gjithë së bashku: krijoni galerinë SDG <p>Eksplorimi i veprës së artit dhe kërkimit personal</p> <p>(Përgatiteni këtë paraprakisht) - Shtroni pjesët e printuara të artit (shtojca I) në tavolinat përreth dhomës.</p> <p>Lëri studentët/et të ecin nëpër dhomë për disa minuta duke parë pjesët. Pas disa minutash, kërkni nga secili/e student/e të zgjedhë një pjesë që i flet. Të gjitha pjesët duhet të merren (në varësi të numrit të nxënësve/eve, disa mund të kenë nevojë të marrin 2, ose çiftëzohen).</p> <p>Pas disa minutash kërkoni nxënësve/eve të ulen me pjesët e tyre. Ata pastaj kalojnë disa minuta të tjera duke hulumtuar këtë pjesë në pajisjet e tyre personale dhe duke reflektuar mbi atë që shohin dhe çfarë do të thotë kjo për ta.</p>	Prezantimi 1
15 min	<p>Fokus grupe</p> <p>Nxënësit mbledhen në grupe nga 3-7 persona. Kërkojuni të ndajnë me të tjerët atë që kanë mësuar rreth pjesës së tyre. Në ekran ata/o mund të gjejnë disa pyetje udhëzuese për t'iu përgjigjur/ndarë.</p> <p>Idealisht është një mësues/punonjës social në secilin grup për të drejtuar diskutimin, por kjo nuk është një domosdoshmëri.</p>	Prezantimi 1 Pyetje udhëzuese në prezantim
10 min	<p>MKrijimi i kuizit/galerisë së SDG:</p> <p>Opsioni 1: Krijoni një kuiz arti SDG në Kahoot (ose Mentimetër, ose një mjet tjetër për të bërë kuiz). Gjeni dokumentet për pjesët e artit dhe emrat e tyre në folderin e lidhur. Ju poashtu mund të përdorni zgjedhjen tuaj të pjesëve të artit, për sa kohë që i lidhni me SDG-të. Gjeni pjesët e artit në manualin e trajnerëve dhe përdorni 4 SDG të ndryshme si kategoritë e përgjigjeve (me një të saktë).</p>	Prezantimi 1 Opsionet e materialit 1 dhe 2 Nëse është e nevojshme:

	<p>Opsioni 2: Si alternativë për Kahoot ju mund ta bëni galerinë me printime. Nëse ekrani/tabela juaj është mjaft e madhe, projekttoni galerinë e SDG-ve të zbrazët. Nëse jo, mund të printoni faqet e zbrazëta të galerisë së SDG-ve nga manuali dhe të vendosni/varni 17 faqet e SDG-ve (shtojca II). Çdo faqe tregon numrin, SDG-në dhe gjysma e hapësirës së zbrazët është për veprën e artit. Për këtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kërkojuni studentëve/eve të bashkojnë pjesët e tyre të artit (duke përdorur ngjitës/pulla ngjitëse) në pjesën e zbrazët të SDG-së me të cilën mendojnë se është e lidhur. • Bëjeni këtë një nga një, duke dhënë mundësinë për të diskutuar për SDG së shpejti. • Kjo mund të bëhet pak e çrregullt pasi disa pjesë mund të lidhen me SDG të shumta. Ndhmoni këtu për të gjetur "vendin e duhur" aty ku është e nevojshme. 	<p>- Shtypni faqet e zbrazëta të galerisë SDG nga manuali për trajnerët</p> <p>- Pulla ngjitëse për ti varur veprat e artit në galeri</p>
5 min	<p>Përfundoni dhe jepni detyrat e shtëpisë²</p> <p>Nxënësit/et do të punojnë në përcaktimin e së ardhmes që parashikojnë. Ata e bëjnë këtë duke plotësuar një numër pyetjesh (shih fletoren e punës) për t'i udhëzuar ata në krijimin e një vizioni të qytetit të tyre të lulëzuar dhe më pas duke krijuar një tabelë humori/disponimi. Ata/o do të fillojnë të përdorin prirjet e tyre artistike për të shprehur ëndrrat e tyre.</p> <p>Tregojuni studentëve/eve dy programe në internet (Adobe Creative Cloud Express dhe Canva) që ata mund t'i përdorin për të krijuar një tabelë humori (moduli 3 i materialeve).</p>	<p>Prezantimi 1</p> <p>Pjesëmarrësit e fletores së punës: Një vizion i një qyteti të lulëzuar dhe krijimi i një table humori</p> <p>Adobe Creative Cloud Express</p> <p>Link to Canva</p>

1.2: Krijimi i tabelave të disponimit

Time	Process	Materials
45 mins	<p>Detyrë individuale.</p> <p>Nxënësit/et plotësojnë faqen në fletoren e punës, duke krijuar një vizion dhe në bazë të tij bëjnë një tabelë humori. Shihni fundin e modulit të mëparshëm për më shumë informacion.</p> <p>Nxënësit/et ia dorëzojnë mësuesit online materialin e plotësuar dhe tabelën e disponimit. Shtoni udhëzimet tuaja se si nxënësit/et mund ta bëjnë këtë.</p>	<p>Prezantimi 1</p> <p>Pjesëmarrësit e fletores së punës: Një vizion i një qyteti të lulëzuar dhe krijimi i një table humori</p>

1.3: Online exposition

Time	Process	Materials
5 mins	<p>Hyrje</p> <p>Mësime në grup në internet - mund të bëhen edhe në klasë në një ekran të madh.</p> <p>Përgatitja: përgatitni të gjitha tabelat e disponimit në një prezantim në</p>	<p>Prezantimi 1</p> <p>Këshillë për ekspozimin në internet: përdorni në Miro një tabelë të bardhë në internet.</p>

² If your training is held in one day or doesn't involve homework assignments, give this task to participants as a part of the training.

	<p>internet (Miro është një mjet i shkëlqyeshëm për këtë!) ku ju e dini se kush zotëron cilën tabelë disponimi, por kjo nuk dihet për studentët. Kjo është e rëndësishme për të arritur në një vlerësim objektiv dhe për të shmangur "favoritizimin".</p> <p>Filloni me skicën e këtij mësimi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Filloni mësimin me videon "SDG-të: ne njerëzit". 2. Shikoni tabelat e disponimit individualisht 3. Diskutoni komentet sipas tabelës së disponimit dhe lëri ta shkruajnë këtë (në Miro kjo është një hapësirë e përbashkët pune që është e dukshme për të gjithë) 4. Skico profilin e heroit 5. Shpjegoni hapat e ardhshëm 	<p>Prezantimi i Webinarit Miro: https://youtu.be/pJLLAEmhSho</p> <p>More info on Miro: https://help.miro.com/hc/en-us/articles/360017571954-How-to-Start-Collaboration-with-Miro</p> <p>Video SDG "we the people"</p>
10 mins	<p>Shikoni tabelat e disponimit në mënyrë individuale dhe shkruani komente.</p> <p>Më vete nxënësit shikojnë çdo tabelë disponimi dhe shkruajnë vetë se cilat mendime/ide/përshtypje u vijnë në mendje.</p> <p>Këshillë: lëri të shkruajnë komentet direkt në Miro, në mënyrë që të jenë menjëherë të dukshme për të gjithë grupin.</p>	Prezantimi 1
20 mins	<p>Diskutoni komentet sipas tabelës së humorit.</p> <p>Diskutoni çdo tabelë disponimi në klasë. Përmbledhni komentet. Pyetni nëse është e qartë për të gjithë. Shumë shpejtë.</p> <p>Vetëm atëherë zbuloni kush e ka shkruar. Lëri studentët të përgjigjen. Ku është befasia? Apo ndoshta njohja e punës së dikujt?</p>	Prezantimi 1
10 mins	<p>Skicimi i vizioneve të së ardhmes</p> <p>Kërkojuni studentëve/eve të diskutojnë me njëri-tjetrin se cilat tema ata shohin që ndeshen pasi të diskutojnë të gjitha tabelat individuale të diskutimit. Dhe ku janë dallimet?</p> <p>Së bashku arrijmë të një vizion se si duhet të duket e ardhmja jonë e përbashkët (në disa pika). Ky vizion dhe tabelat individuale të disponimit mund të përdoren më vonë si frymëzim për projektet e tyre në komunitet.</p> <p>Përmbledhni dhe përfundoni</p>	Prezantimi 1

Kohëzgjatja

Ky sesion përmban 3 pjesë nga 45 minuta secila. Një pjesë është koha e vetë-studimit.

Koha totale e studimit është 2 orë e 15 minuta, gjysma e të cilave janë orë kontakti.

Paraprakisht nxjerrni gjërat kryesore që dëshironi t'i merrni nga video. Në klasë, bisedoni me grupin se çfarë u bëri përshtypje më së shumti në video.

Për shembull, përdorni videon e trajnerit belg të talentit Luk Dewulk.

Për versionin anglisht të Luk Dewulk duke sqaruar talentin shihni (nëse jeni në klasë, shikoni vetëm 5 minutat e parë të videos):

<https://www.youtube.com/watch?v=QHMuss1vq7Q>

Gjërat kryesore për t'i nxjerrë nga video e mësipërme për t'u diskutuar:

Talenti u referohet të gjitha atyre aktiviteteve në jetën tuaj që janë pa shumë mundim dhe që ju sjellin kënaqësi.

Paradoksi 1: personi me talent shpesh është i fundit që e njeh talentin, sepse e bën punën pa shumë mundim.

Paradoksi 2: talenti është diçka individuale por njihet vetëm kur vërehet nga të tjerët. "Nëse jeni i/e mirë në atë që bëni, ju i mbushni bateritë. Qëndrueshmëria juaj do të rritet. Edhe aftësia juaj për t'u marrë me gjithçka që është e vështirë rritet.

Sesioni 2. Talentet

Materialet:

- [Prezantimi 2](#)
- [Manuali i trajnerëve/eve](#)
- [Fletore e punës për pjesëmarrësit/et](#)

Time	Instructions	Materials
5 min.	<p>HYRJE</p> <p>Interesi - qëllimi: të tërheqë vëmendjen e grupit. Përdorni një metaforë, citat, pamje. Shikoni prezantimin për një shembull që përdorim në sesionin holandez.</p> <p>Nevoja - kur bëni atë në të cilën jeni të mirë, kjo do t'ju japë energji. Bëhet fjalë për aktivitete që janë të lehta dhe të kënaqshme për ju. Këto janë talentet tuaja.</p> <p>Koha - informoni pjesëmarrësit se seanca zgjat 1.5 orë dhe diskutoni temat.</p> <p>Përgjigja - Në fund të seancës, ju jeni në gjendje të listoni disa lloje talentesh dhe keni një ide se cilat janë talentet tuaja dhe si rrjedhojë çfarë ju jep energji.</p> <p>Objektivat - Informoni pjesëmarrësit/et për qëllimet mësimore të këtij sesioni specifik.</p>	Prezantimi 2
15 min.	<p>Përkufizimi i talentit</p> <p>Qëllimi: të kuptojmë se çfarë nënkuptojmë me talent dhe të kuptojmë se të gjithë kanë talent dhe se kjo ndryshon nga personi në person. > qëllimi mësimor 4.2</p> <p><u>Zgjidhni një video në gjuhën tuaj kombëtare për talentin për ta parë në klasë. Max. 5 minuta. Më pas bëni një diskutim në grup.</u></p> <p>Nxirni së pari ato që dëshironi të merrni nga video. Në klasë, diskutoni me grupin se çfarë u bëri më së shumti përshtypje rreth kësaj videoje.</p> <p>Për shembull, përdorni videon e trajnerit belg të talenteve Luk Dewulk. Për një version në gjuhën angleze ku Luk Dewulk e sqaron talention shikoni (nëse jeni në klasë, lëshoni vetëm 5 minutat e parë të videos): https://www.youtube.com/watch?v=QHMuss1vq7Q</p> <p>Gjërat kryesore të videos së mësipërme për t'u diskutuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Talenti u referohet të gjitha atyre aktiviteteve në jetën tuaj që janë pa mundim dhe ju sjellin kënaqësi. - Paradoksi 1: Personi me talent është shpesh i fundit që e njeh talentin, sepse e bën punën pa shumë mundim. - Paradoksi 2: Talenti është diçka individuale, por njihet vetëm kur vihet re nga të tjerët. - "Nëse bëni atë në të cilën jeni të mirë, ju i mbushni bateritë tuaja. Rezistenca juaj do të rritet. Edhe aftësia juaj për të përballuar gjithçka që është e vështirë rritet." 	Prezantimi 2 <p>(!) Fusni lidhjen e videos në variantin tuaj të prezantimit</p>
15 min.	<p>Inteligjenca e shumëfishtë</p> <p>Qëllimi: të dihet se cilat janë kategoritë e talenteve, bazuar në teorinë e inteligjencës së shumëfishtë. > qëllimi mësimor 4.1</p>	Prezantimi 2

Time	Instructions	Materials
	<p>Paraqisni teorinë e inteligjencës së shumëfishtë duke përdorur prezantimin dhe shënimet në prezantim.</p> <p>Stili i të nxënit - teorik Kjo u përshtatet teoricienëve pasi ofron informacion bazë mbi një teori të talentit.</p>	
30 min	<p>Kuiz i talenteve</p> <p>Qëllimi: Pjesëmarrësit mund të demonstrojnë se çfarë talentesh kanë. > qëllimi mësimor 4.3</p> <p>Në klasë, plotësoni me pjesëmarrësit/et fletën e kuizit të talenteve. Shpjegoni se do t'i përshkruani talentet një nga një dhe do të jepni shembuj (shih fletushkën). Pas një shpjegimi, pjesëmarrësit/et plotësojnë shiritin përkatës në fletën e punës. Minimumi është 20%, maksimumi 80%. Kurrë nuk zotëroni një formë inteligjence plotësisht ose aspak! Plotësoni informacionin bazuar në ndjenjën tuaj të parë. Inkurajoni pjesëmarrësit/et të jenë të sinqertë/a dhe të bëjnë pyetje kur nuk është e qartë.</p> <p>Learning style - activist This suits the activist because it requires choices and is an active form of work.</p>	<p>Prezantimi 2</p> <p>Pjesëmarrësit e Fletores së Punës:</p> <p>Stilolapsa</p> <p>Manuali Trajnerët</p>
20 min	<p>Reflektimi</p> <p>Qëllimi: Reflektoni për gjithçka të mësuar dhe zbatuar. > qëllimi mësimor 4.4</p> <p>Kërkojuni pjesëmarrësve/eve, individualisht dhe në heshtje, të plotësojnë pyetjen e parë në fletën e punës 'Talentet e reflektimit'. Pas pesë minutash, ata diskutojnë gjetjet e tyre me personin që ulet pranë tyre. Ata me radhë i tregojnë njëri-tjetrit se çfarë talentesh kanë.</p> <p>Detyrë shtëpie: kur pjesëmarrësit/et kthehen në shtëpi, ata pyesin familjen dhe/ose miqtë nëse i njohin talentet e tyre. Ata/o i pyesin se ku mendojnë se qëndrojnë talentet e pjesëmarrësve. Pjesëmarrësit e plotësojnë këtë në fletën e punës. Si dhe një përshkrim të talenteve me të cilat do të dëshironin të punonin (të zhvillohen më tej).</p> <p>Stili i të mësuarit - pragmatist Mundësia e vetë pjesëmarrësit/es për të nxjerrë përfundime praktike.</p>	<p>Prezantimi 2</p> <p>Fletore Pune Pjesëmarrësit</p> <p>Stilolapsa</p>
5 min.	<p>Mbyllja</p> <p>Informoni pjesëmarrësit/et se kur do të takoheni përsëri dhe çfarë është në agjendë atëherë.</p>	<p>Prezantimi 2</p>

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e seancës është 1.5 orë.

Sesioni 3. ART-i për Ndryshim Social: Ideimi

Materiale:

- [Prezantimi 3](#)
- [Manuali i trajnerëve](#)
- [Fletore e punës për pjesëmarrësit/et](#)

3.1: Workshop: Format e të shprehurit

Time	Process	Notes
2 mins	<p>Jepni një përmbledhje të shkurtër të pjesës së parë të "Arti për Ndryshim Social", ku studentët u njohën me SDG-të dhe idenë e përdorimit të artit për të trajtuar çështjet sociale/mjedisore. Ju mund t'i shfaqni në ekran disa nga tabelat e disponimit që ata/o kanë krijuar.</p> <p>Sot do të eksplorojmë forma të ndryshme krijuese të të shprehurit. Pse? Sepse ju do të përdorni një nga këto (ose një medium tjetër krijues) në projektin tuaj përfundimtar të komunitetit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kujtojeni nxënësve konceptin ARTIVIZMI: Art + Aktivizëm • Forma të ndryshme të të shprehurit - Bëni një re fjalësh <p>Ndani një vegëz me studentët ku ata mund të fusin një fjalë, një formë shprehjeje krijuese. Përmendni sesi secili prej nesh ka aftësi, interesa dhe prirje të ndryshme. Ky kreativitet është i pakufishëm dhe këto fjalë janë vetëm disa nga mënyrat në të cilat ne shprehemi. Në realitet, këto forma mund të kalojnë kufijtë midis njëra-tjetrës dhe të marrin një formë të ndryshme për secilin/ën. Sot do t'u hedhim një sy atyre kryesore, por kini parasysh se kjo nuk është gjithëpërfshirëse.</p> <p>Sot do të shqyrtojmë 5 forma të artvizmit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Filma që kanë rëndësi • Hip hopi si rezistencë • Performancë poezie • Fotografia • Arti i rrugës <p>Është një hyrje e shkurtër në aspektet stilistike të secilës formë, nga një shembull i një veprimi komunitar ose ndikimi i përgjithshëm shoqëror. Këto duhet të jenë burime frymëzimi për projektin tuaj të komunitetit.</p>	<p>Prezantimi 3</p> <p>Tabelat e disponimit të nxënësve.</p> <p>Mentimeter - Krijuesi i Word Cloud</p>
5 min	<p>1. Artvizëm: Filma që kanë rëndësi</p> <p>“Filmat që kanë rëndësi” është një festival filmi i cili shfaq filma që kanë një lidhje me ndryshimet sociale ose mjedisore, ata kanë rëndësi. Përmes QR kodit, i çon studentët/et në faqen e internetit të festivalit. Atje ata/o kanë qasje në shumë prej dokumentarëve, filmave dhe filmave të shkurtër dhe mund të përdoren si burime frymëzimi.</p> <p>Shfaq trailerin e filmit Luftëtarët e Lirisë (Freedom Fighters). Është një film frymëzues për një mësues që motivon një grup të rinjsh "fëmijë me probleme" duke bërë art.</p>	<p>Prezantimi 3</p> <p>Trailer Freedom Fighters</p>
5 min	<p>2. Artvizëm: Hip hopi është Rezistencë</p>	<p>Prezantimi 3</p> <p>Youtube video</p>

	<p>"Gjeniu i hip hopit u shfaq fillimisht si sport partie -- të varfërit urbanë që ripërdorin pjesë muzikore për të krijuar diçka krejtësisht të re -- por shpejt u shndërrua në një shprehje pikëllimi dhe zemërimi kur Ronald Reagan, kokaina e pastër dhe dhuna e bandave qëndisën mjerimin mes afrikano-amerikanëve. Komunitetet amerikane dhe getot nga Harlemi deri në Compton u shfaqën në hartë ndërsa MC-të (reperët) në mënyrë sfiduese e shënuan historinë e pacensuruar të Amerikës së Reganit."</p> <p>Shfaq videon në youtube "Hip-Hop është sërish politik. Ja përse." nga Vox</p>	
15 min	<p>3. Artivizmi: Performancë Poezie</p> <p>Trego Performancën poetike të Aiya Meilanit. Kërkojuni studentëve/eve t'i shkruajnë pjesë që u pëlqen ajo që thotë Aiya. Dhe cilat tema që ajo i përmend u pëlqyen? Reflektoni së bashku.</p> <p>Informacion: Poezia e Aiya-s është një koment i pasionuar dhe kompleks se si shoqëria sot po na dështon ne dhe botën përreth nesh..</p> <p>Performanca poetike fokusohet në çështjet sociale dhe politike. Performanca Poetike filloi nën retë e rënda dhe të errëta të kolonizimit dhe padrejtësive sociale dhe ekonomike të traditës kolonialiste.</p> <p>Struktura e performancës tradicionale filloi nga punëtori i ndërtimitarisë dhe poeti Marc Smith në vitin 1986 në një seri leximi në një klub të muzikës xhez në Çikago. Konkurrenca u përhap shpejt në të gjithë vendin, duke gjetur një shtëpi të dukshme në New York City në kafenenë "Poetët Njujorkas".</p> <p>Përbërësit kryesorë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Një histori e mirë - asgjë nuk e mposht një histori të mirë, madje as rima e mirë apo formulimi më i mirë. Rima nuk është e nevojshme nëse doni të performoni, por duhet të mendoni për fjalët që po vendosni në poezinë tuaj. Thjesht filloni duke shkruar historinë tuaj, një draft të parë. Shkruani draftin tuaj të parë të udhëhequr nga mendimet, ndjenjat dhe emocionet tuaja për ngjarjen ose historinë që keni vendosur të theksoni. Ky draft do t'ju lejojë t'i shihni fjalët në letër që të mund t'a rregulloni më vonë. Vazhdoni të rishikoni modifikimin me fraza më të mira, formulime apo edhe rimime më të mira nëse doni të ketë një tingull të këndshëm. 2. Performanca - Performanca është më shumë se gjysma e betejës në performancën poetike. Performoni poezinë tuaj me zë të lartë për veten. Përsosni tonin, zërin, gjestet dhe aspektet e përgjithshme performuese që do të përshtateshin me fjalët tuaja. 3. Audiencia - angazhimi i audiencës. <p>Qëllimi juaj është të fitoni turmën duke i bërë ata/o të ndiejnë diçka.</p> <p>Mjetet stilistike</p> <ul style="list-style-type: none"> • Figurat e të folurit - Prezantoni konceptin e figurave të të folurit. Qëllimi: për të sjellë tekstin të gjallë, për të krijuar një efekt. • Aliteracioni = përdorimi i të njëjtit tingull bashkëtingëllor fillestar në një rresht ose në një varg. Shembull: Pjetri pa para përtoke përballë pasqyrës. • Metafora = një formë e gjuhës figurative, e cila u referohet fjalëve ose shprehjeve që nënkuptojnë diçka të ndryshme nga përkufizimi i tyre i parë. Shembull: jetë qeni. Do të thotë se është një jetë e trishtuar, e mjerë. • Antitezë = krahasimi i dy realiteteve, sendeve etj., njerëzve që kanë karakteristika të kundërta. Shembuj: derisa fëmijët e pasur hedhin ushqimin, fëmijët e varfër nuk kanë bukë. Ndërsa sytë e mi qeshin, zemra më qan dhe unë hesht por ka një stuhi në shpirtin tim. 	<p>Prezantimi 3</p> <p>Link to video: https://youtu.be/aWbERlVc7BM</p> <p>Më shumë informacion mbi sfondin mbi Slam Poetry: https://www.imaginated.com/writing-glossary/wat-is-slam-poetry/</p> <p>Lidhja me videon e shpjegimit të metaforave: https://youtu.be/JPEmbt8Ooy0</p> <p>Burimi: https://poets.org/text/brief-guide-slam-poetry & https://www.nuyorican.org/</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • Krahasimet = përfshijnë dy terma që kanë të përbashkët një element, të cilin e përdorim për të theksuar një ide. Shembuj: i fortë si guri, i ëmbël si mjalti. <p>Ushtrim 5 min: Rimë e shpejtë Kërkojuni nxënësve/eve të krijojnë një rimë (2-4 rreshta) për temën e pabarazive. Ata/o duhet të përdorin të paktën një nga pajisjet stilistike. Ndajeni me personin që ulet pranë tyre. Jepuni kohë 2-3 nxënësve/eve që të ndajnë me klasën atë që kanë shkruar.</p>	
15 min	<p>4. Artivizëm: Fotografi për ndryshim</p> <p>Shembuj të fotografisë së artivizmit Shembuj fotografish që kishin një rëndësi historike duke qenë një formë artivizimi. Përpara se të thoni emrin dhe kontekstin e tyre, pyesni studentët/et nëse dikush i njeh ato.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tanksiti në sheshin Tiananmen, 1989 <ul style="list-style-type: none"> ○ Kjo fotografi është bërë nga Stuart Franklin, një fotograf britanik, më 5 qershor 1989, një ditë pas masakrës së sheshit Tiananmen, në të cilën besohet se rreth 10,000 protestues pro-demokracisë në Pekin u vranë nga trupat e dërguara për të shtypur demonstratat. Një protestues i vetmuar, i quajtur "Tankisti", qëndroi duke bllokuar rrugën e një kolone tankesh që dilnin nga sheshi. Pamjet e incidentit u nxorrën kontrabandë nga Kina, me burrin ende të paidentifikuar që u bë menjëherë një ikonë në botën perëndimore. Siç tha Franklin: "Këtu ishte një version modern i Davidit dhe Goliathit." (Artikulli i The Guardian) • Emma Sulkowicz bart një dyshek, 2014 <ul style="list-style-type: none"> ○ Nuk ka shumë projekte artistike studentore që marrin aq vëmendje sa teza e vitit të fundit të Emma Sulkowicz në Universitetin Columbia në Nju Jork. Për performancën e dyshekut (Carry That Weight), Sulkowicz u zotua se do të bartte një dyshek kudo që të shkonin në kampus derisa shkolla të pranonte të përjashtonte një student tjetër të cilin ata e kishin akuzuar për përdhunim. Performanca vazhdoi deri në diplomimin e tyre - dhe u bë një simbol i fuqishëm i protestës kundër kulturës së përdhunimit në universitete. "Ai imazh," tha Hillary Clinton në 2015, "duhet të na ndjekë të gjithëve". • Rosa Parks zë vendin e saj në autobus, 1956 <ul style="list-style-type: none"> ○ Kjo është marrë më 21 dhjetor 1956, ditën kur përfundoi ndarja sipas racave e sistemit të transportit publik në Montgomery, Alabama. Më shumë se 12 muaj më parë, Rosa Parks ishte arrestuar pasi kishte refuzuar të hiqte dorë nga vendi i saj për një burrë të bardhë, duke shkaktuar bojkotin 382-ditor të autobusëve të Montgomery - demonstrata e parë në shkallë të gjerë kundër ndarjes etnike në SHBA. Burri i bardhë në këtë foto nuk ishte një pasagjer i rastësishëm, por gazetari veteran i UPI-së, Nicholas Chriss: fotografia u inskenua nga një fotograf që nuk iu dhanë kredi për të ilustruar këtë fitore të rëndësishme. <p>Këta janë shembuj të fotografive që kapin momente artivizimi, por artivizmi përmes fotografisë mund të bëhet edhe me perspektiva të thjeshta, të përditshme. Trego disa shembuj.</p>	<p>Prezantimi 3</p> <p>Këshillë për frymëzimin e fotografive: https://unsplash.com/</p> <p>"Ndihej si vetë historia" – 48 fotografi proteste që ndryshuan botën The Guardian Article</p>

	<p>Bazat e fotografisë</p> <p>Shpjegoni se çfarë do të thotë fjala "foto" (të shkruarit me dritë) dhe tregoni evolucionin e kamerës.</p> <p>Katër aspektet kryesore të fotografisë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Drita: fotot mund të bëhen me dritën e ditës ose me dritë artificiale. Ora para perëndimit të diellit quhet 'ora e artë' sepse drita i bën fotot të veçanta. 2. Ngjyra: si fotograf/e ju keni mundësi të ndryshme për të luajtur me ngjyra në foton tuaj. 3. Përbërja: si një fotograf/e rendit sende të ndryshme sipas pamjes së tyre. Sa tërheqëse është një foto? 4. Perspektiva: këndvështrimi ynë ose në fakt ai i kamerës. <p>Fotografia në artivizëm: Tregoni tre fotografitë që hedhin dritë mbi çështjet socio-mjedisore. Nëse ka kohë, pyesni se me çfarë u asociojnë fotografitë dhe cilat çështje socio-mjedisore trajtojnë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bardh e zi: gardh: kufij dhe padrejtësi • Bimë në tokë të çertifikuar: Rigjenerim ekologjik dhe i qëndrueshëm • Protesta, unitet, drejtësi sociale <p>Ushtrim (5 min)</p> <p>Lërimi studentët/et të luajnë me iluzionin optik (duke bërë një foto nga një këndvështrim i çuditshëm). Lërimi të punojnë në grupe prej katër vetash. Lërimi të tregojnë figurën në klasë kur të kthehen. Mund të përdorin celularët e tyre.</p>	
3 min	<p>5. Art rruge</p> <p>Shpjegoni konceptin e artit të rrugës dhe ndryshimin e tij me mbishkrime.</p> <p>Arti i rrugës është një formë e veprës artistike që shfaqet në publik në ndërtesat përreth, në rrugë, trena dhe sipërfaqe të tjera të ekspozuara ndaj publikut. Shumë raste vijnë në formën e artit gueril, i cili synon të bëjë një deklaratë personale për shoqërinë në të cilën jeton artisti. Puna është zhvendosur nga fillimet e grafiteve dhe vandalizmit në mënyra të reja ku artistët punojnë për të sjellë mesazhe, ose thjesht bukuri, te një audiencë.</p> <p>Ftojini studentët/et të diskutojnë rrjedhshëm pyetjet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pse na duhet të shohim artin në rrugë (jo në muze apo hapësira të tjera të destinuara posaçërisht)? Shkruani gjetjet e tyre në dërrasën e bardhë ose në flipqart. - Çfarë është më e rëndësishme: të shohësh vepra të bukura arti apo ato që trajtojnë problemet në shoqëri apo planet? - A njihni ndonjë artist rruge me emër? Pse artistët e rrugës janë më pak të njohur për publikun? Çfarë i duhet një artisti rruge për t'u parë dhe njohur? <p>Tregoni shembullin e artistëve të mirënjohur (ose veprave të njohura) që japin mesazhe të forta sociale, politike ose mjedisore.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Çfarë ndjenjash provokojnë ato? A e ndjeni dëshirën për të vepruar kur i shihni? Pse (nëse po ose jo)? - A mendoni se kushdo mund të jetë artist rruge? Shpjegoni përgjigjen tuaj. <p>Përfundoni seancën duke theksuar fuqinë e artit të orientuar nga shoqëria.</p>	<p>Trego shembuj të arteve të ndryshme të rrugës dhe grafiteve në qytetin/lagjen tuaj</p> <p>Prezantimi 3</p>
	<p>Detyrë individuale: Krijim arti</p>	<p>Prezantimi 3</p>

	<p>Nxënësit krijojnë vepra arti individuale (një nga 7 format krijuese të sugjeruara). Ata/o duhet ta sjellin këtë (në çfarëdo forme që ata/o zgjedhin) në mësimin tjetër ku do të ndajnë krijimet e tyre me shokët e klasës. Më shumë detaje mund të gjenden më poshtë dhe në "Fletoren e punës së pjesëmarrësve".</p> <p>Udhëzime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zgjidhni një temë që ju intereson. • Zgjidhni formën tuaj të artit që ju flet më shumë ose që tashmë e praktikoni. Shikoni disa video në YouTube për këtë formë shprehjeje për të fituar më shumë njohuri për disa mjete stilistike që mund t'i përdorni në procesin tuaj. • Duke përdorur këtë medium, krijoni diçka që pasqyron ose trajton temën që keni zgjedhur. Udhëzimet për këtë janë shumë të hapura dhe lënë shumë liri shprehëse, ndaj jini kreativ! • Udhëzime për formularin krijues <ul style="list-style-type: none"> ○ Fotografi: 5 fotografi duke përdorur parimet e diskutuara në sesion dhe të edituara. Emri i serisë së fotografive dhe 1-3 fjali që zgjerojnë kuptimin dhe lidhjen e tyre me SDG-në e zgjedhur. ○ Vizatim/Skicim/Pikturë: 1 copë ose një seri vizatimesh. Emri i veprës së artit dhe 1-3 fjali që zgjerojnë kuptimin dhe lidhjen e tyre me SDG-në e zgjedhur. ○ Poezia: Një poezi e shkruar në lidhje me SDG-në e tyre të zgjedhur. Përdorni të paktën 3 mjete stilistike. Në të folur duhet të duhen maksimumi 3 minuta për t'u kryer. ○ Krijimi i filmit/videos: Një klip filmi maksimumi 3 min. ○ Muzika: Një këngë/pjesë muzikore e kompozuar vetë OSE një kover i një kënge/pjesë muzikore ekzistuese. Kjo mund të jetë me ose pa tekst, por duhet të lidhet me SDG-në tuaj në një farë mënyre (për shembull, duke treguar një histori përmes toneve dhe melodisë ose duke qenë kolona zanore e një filmi ose videoje që trajton çështje socio-mjedisore). Nëse pjesa muzikore nuk përfshin tekste, atëherë shkruani 1-3 fjali duke shpjeguar pse kjo pjesë është e rëndësishme për SDG-në që keni zgjedhur. <p>Shënim: mund t'u jepni studentëve/eve mundësinë që të propozojnë formën e tyre të artit dhe kjo të konfirmohet nga ju.</p>	
--	--	--

3.2: Gjetja e formës suaj

Time	Process	Notes
5 mins	<p>Prezantimi</p> <p>Përmbledhje: Në punëtori kemi eksploruar medime të ndryshme krijuese, ose forma të të shprehurit. Ne kemi eksploruar gjithashtu mundësinë dhe fuqinë në adresimin e problemeve sociale përmes artit.</p> <p>Sot</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndarje kreative • Ideja e projekteve komunitare 	Prezantimi 3
20 min	Ndarje kreative	Prezantimi 3

	Nxënësit/et formojnë grupe. Ata/o ndajnë me shokët/shoqet e tyre student/e atë që kanë krijuar. Çdo 3 minuta kërkojuni të kalojnë te personi tjetër në mënyrë që të gjithë të kenë mundësinë të ndajnë krijimin e tyre.	
5 min	<p>Ide për projektin kreativ të komunitetit</p> <p>Shembull: Muret e lidhjes Sot, brenda grupeve tuaja tematike, ju do të ideoni (krijoni ide) për projektin tuaj të komunitetit. Ky projekt do të përdorë konceptin e artit për ndryshim social për të trajtuar një çështje sociale/mjedisore të cilën e keni identifikuar në sesionin e portretit të qytetit.</p> <p>Si shembull, ndani "muret e lidhjes"</p> <p>Shumë mure janë ndërtuar në botë për të ndarë njerëzit nga njëri-tjetri. Mendoni për shembull Murin e Berlinit, murin meksikan ose murin kinez. Por mendoni edhe për muret imagjinare që janë ngritur, për shembull, nga frika nga muslimanët, migrantët, etj. Si mund të sigurohemi që t'i shembim këto mure dhe të sigurojmë lidhje?</p> <p>Shfaq videon për muret e lidhjes në Holandë.</p> <p>Më shumë shembuj të projekteve kreative të komunitetit</p> <p>Shfaqni sllajdin me listën e shembujve të projekteve krijuese të komunitetit dhe lexoni disa nga idetë. Theksoni se kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse, por është vetëm për të demonstruar shumë forma të ndryshme që mund të marrë ky projekt. Natyrisht, ata/o mund të frymëzohen nga kjo, por inkurajoni studentët/et të krijojnë idetë e tyre unike. Ky proces do të eksplorohet tani në një sesion idesh.</p>	<p>Prezantimi 3</p> <p>Lidhja me videon Muri i Lidhjes në Waddinxveen, Holandë</p> <p>Më shumë informacion mbi Walls of Connection</p>
20 min	<p>Stuhi mendimesh në grup Nxënësit mblidhen në 4-6 grupe bazuar në interesa të ngjashme (temat që kanë zgjedhur për krijimet individuale). Në grupet e tyre ata tani do të plotësojnë 2 fletë idesh për të formuluar ide për projektet e tyre krijuese në komunitet.</p> <p>Material – ide për renë e fjalëve Në fletoren e punës nxënësit/et kanë faqen "Ideimi i resë së fjalëve". Ata mund ta përdorin këtë format për të udhëhequr procesin e tyre të stuhisë së ideve. Lejoni fleksibilitet dhe liri krijuese në këtë proces.</p> <p>ARTI "Re fjalësh"</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Reflektoni për formën e artit që keni zgjedhur secili për krijimin tuaj ● Si ju pëlqen të shpreheni? Fjalët? Muzika? Lëvizja? Piktura? ● Çfarë kemi të përbashkët? ● Nëse interesat/prijet tona ndryshojnë, si mund t'i kombinojmë ato në mënyrë krijuese? <p>AKTIVIZMI "re fjalësh" <i>Gjetja e problemeve tuaja lokale sociale/mjedisore/komunitare specifike për temën tuaj bazuar në portretin e qytetit</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ● Në çfarë lloj iniciativash/projektesh/pune vullnetare sociale/mjedisore keni qenë të përfshirë më parë? ● Ku dëshironi të shihni ndryshimin? 	<p>Prezantimi 3</p> <p>Pjesëmarrësit e Fletores së Punës: Formulimi: Projekti ynë krijues i komunitetit</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • Cilat çështje sociale/mjedisore mendoni se janë veçanërisht të rëndësishme? <p><i>ARTIVIZMI "re fjalësh"</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Si mund të kombinoni ART-in dhe AKTIVIZMIN? • Çfarë lloj projektesh komunitare mund të vijjnë nga kjo? <p>MATERIAL - Formulimi</p> <p>Në fletoren e punës nxënësit kanë faqen "Formulimi: Projekti ynë kreativ i komunitetit". Ata mund ta përdorin këtë format për të udhëhequr procesin e tyre të stuhisë së ideve. Lejoni fleksibilitet dhe liri krijuese në këtë proces.</p> <p>3 seksione, 1 për secilën ide</p> <p>Për çdo ide (shprehuni me fjalë dhe/ose skica):</p> <ul style="list-style-type: none"> • Çfarë problemi(esh) të komunitetit lokal social/mjedisor po trajton kjo ide? • Cilat forma arti janë të përfshira? • Çfarë do të bëni? • Si e trajton kjo çështjen? (avokimi, aspekti edukativ, ndikimi, etj.) • Palët e interesit? <ul style="list-style-type: none"> ○ Kush do të ndikohet? ○ Kush i ka burimet e nevojshme (ekspertizë/aftësi/para)? • Në cilën hapësirë(a) mund ta bëni projektin tuaj dhe kush ka kontroll mbi to? <p>Deri në fund të sesionit, çdo grup duhet të ketë përpiluar një listë (deri në) 3 ide gjysmë konkrete të një projekti komunitar që kombinon një formë krijuese të shprehjes dhe temën me të cilën keni punuar (shënim: nëse keni një ide me të cilën jeni të gjithë dakord dhe pasonantë për të, atëherë thjesht përqendrohuni në atë).</p>	
	<p>Në pjesën tjetër të projektit DO U ACTism pjesëmarrësit/et do të specifikojnë idenë e tyre krijuese të projektit dhe temën që duan të trajtojnë.</p> <p>Për të organizuar një aksion komunitar për secilën formë artistike të zgjedhur nga nxënësit, jepni udhëzime grupit që ka zgjedhur një formë relevante të artit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Prodhim videosh • Performancë poezie • Punëtori fotografie • Muret e lidhjes 	<p>Shih manualin e trajnerit për udhëzime. Shtypini ato për secilin grup që zgjedh një lloj arti të veçantë. Në rastin e Street Art, do të ketë nevojë për ndihmën e trajnerit me organizimin nga.</p>

Kohëzgjatja

Ky sesion përmban 3 pjesë nga 45 minuta secila. Një pjesë është koha e vetë-studimit. Koha totale e studimit është 2 orë e 15 minuta, gjysma e të cilave janë orë kontakti.

Shtojca I: Manuali i trajnerëve

Shtojca II: Fletorja e punës për pjesëmarrësit/et